



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ**

---

**AD/GJTHFR.1/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës së datës 26.02.2023 nga I.T. dhe F.Sh., me pretendimin shkelje disiplinore nga gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Ferizaj A.B. dhe M.F., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 24.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Ferizaj – A.B. dhe M.F., e paraqitur nga I.T. dhe F.Sh. nga Prishtina, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 26 janar 2023, përmes postës ka pranuar parashtresën e paditësve I.T. nga Prishtina në cilësi të Drejtorit të Departamentit Ligjor pranë personit juridik “R.B.” J.S.C dhe F.Sh. nga Prishtina në cilësi të Menaxherit të Departamentit Ligjor pranë Personit Juridik “R.B.” J.S.C, ku të njëjtët kanë shprehur shqetësimet e tyre të thella në raport me funksionimin si dhe efikasitetin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, në veçanti kur në cilësi të paditësit janë palët private. Sipas ankuesve shqetësimi në këtë parashtresë ka të bëjë me faktin e përdorimit të standardeve të ndryshme në rastin kur palë në procedurë janë gjyqtarët në

cilësi të paditësit sikurse rasti i Gjyqtarit N.M., ndërsa standard tjetër kur palë në procedurë dhe në cilësi të paditësit janë palët private e pikërisht për rastin me bazë të njëjtë juridike në mes palëve të njëjta. Rasti ka të bëjë me padinë gjyqtarit N.M. ndaj Institucionit Financiar “R.B.” J.S.C si dhe zingjirit udhëheqës të zyrës ligjore në “R.B.” J.S.C. Pas ngritjes së padisë së gjyqtarit N.M., Gjykata Themelore në Gjilan përkatësisht ajo në Ferizaj janë treguar mjaftë efikase në procedurën kontestimore konkrete ku për padinë e vitit 2017 dhe atë sipas numrit C.nr.566/2017 e trajtojnë dhe vendosin në lidhje me të njëjtën përmes Aktgjykimit dhe atë me datë 14.11.2017 Gjykata Themelore në Ferizaj i aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit N.M. ashtu që detyron të paditurën R.B. J.S.C që në emër të dëmit moral tia paguaj paditësit N.M. shumln prej 30,000.00 euro si dhe shpenzimet gjyqësore. Me datë 05.05.2022 Gjykata e Apelit të Kosovës, pas ankesës së të paditurës aprovon ankesën dhe lëndën e kthen në rigjykim, ndërsa Gjykata Themelore në Ferizaj cakton për datën 22.02.2023 seancë ku paditës është gjyqtari N.M..

Ankuesit përmes parashtresës kanë njoftuar se për të njëjtën bazë juridike dhe materiale dy përfaqësues të bankës R., në vitin 2018 kanë parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, pra për të njëjtin rast dhe për të njëjtën bazë juridike materiale, kur paditës ka qenë gjyqtari N.M., Gjykata Themelore ka vendosur dhe aprovuar padinë, pastaj ka vendosur Gjykata e Apelit, lënda është kthyer në rigjykim dhe përsëri është ricaktuar seanca përgatitore nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Në anën tjetër për padinë e paraqitur nga paditësit e lartcekur të R.B., Gjykata Themelore në Gjilan as nuk e ka dërguar njoftimin për përgjigje në padi, e lërë me të caktoj seancë e gjithë kjo që nga viti 2018, pra më shumë se pesë vite, duke theksuar se rastet e tilla janë shqetësuese, për faktin e shkeljes së të drejtave të njeriut si dhe për faktin e dëmtimit të imazhit të Këshillit Gjyqësor, Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe asaj në Gjilan, por edhe tërë sistemit të drejtësisë, duke kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore të ndërmerren hapa ligjor për të gjithë akterët të cilët veprojnë me standarde të ndryshme kur kemi situata të njëjta, aq më tepër kur shteti duhet të funksionoj mbi parimin kushtetues e ligjor, ku të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit.

E njëjta parashtresë i është drejtuar Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor, z.Albert Zogaj si edhe Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, z.Venhar Salihu.

Autoriteti kompetent konform nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, parashtresën e palëve I.T. dhe F.Sh., e ka trajtuar si ankesë ndaj

gjqtarëve edhe pse të njëjtit nuk kanë cekur ndonjë emër të gjyqtarëve, pasi nga përmbajtja e ankesës është vlerësuar se qëllimi i palës ka qenë që të paraqesë pretendime për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Autoriteti kompetent pas vlerësimit dhe verifikimit të kësaj ankese ka vërtetuar se lëndët civile në fjalë janë në procedurë në Gjykatën Themelore në Ferizaj, përkatësisht lënda C.nr.566/2017 ku paditës është N.M., ndërsa e paditur R.B. J.S.C, e vendosur sipas aktgjykimit të datës 14.11.2017 nga gjyqtari M.F. dhe e njëjta është në trajtim në procedurën të rigjykimit po te i njëjti gjyqtar tani me numër të ri të SMIL-it 2022:099751.

Ndërsa padia e padia e paditësve I.T. dhe F.Sh., nga Prishtina ndaj të paditurit N.M., nga Gjilan e evidentuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj me numër C.nr.652/19 është në procedurë në zyrë të gjyqtarit A.B.

Gjyqtari i ngarkuar me çështje kontestimore me numër 2022:099751 (e kthyer në rigjykim) M.F., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palëve ankuese përmes parashtrësës së datës 26.01.2023, ka njoftuar autoritetin kompetent me kronologjinë e kësaj çështje. I njëjti ka theksuar se: pranë kësaj gjykate është në zhvillim procedura kontestimore e evidentuar C.nr.2022:099751, sipas paditësve N.M., S.M., D.M., L.M., A.M. dhe L.F., kundër të paditurës R.B. J.S.C me seli në Prishtinë. Po ashtu ka njoftuar se fillimisht padinë paditësi N.M. etj, e kanë ushtruar pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër C.nr.80/15. E njëjta padi, sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës C.nd.nr.70/15 të datës 30.10.2015 ka caktuar në kompetencë të mëtutjeshme Gjykatën Themelore në Ferizaj, e cila lëndë nga Gjykata Themelore në Gjilan është dërguar për në Gjykatën Themelore në Ferizaj përmes aktit përcjellës të datës 16.11.2015 dhe kjo lëndë në Gjykatën Themelore në Ferizaj është pranuar me datë 19.11.2015.

Gjyqtari M.F., ka njoftuar autoritetin kompetent se fillimisht ka qenë i caktuar si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj-divizionin për kundërvajtje, ndërsa nga muaji shkurt i vitit 2016 është caktuar në Departamentin Civil dhe ka pranuar në punë lëndët civile të vitit 2015, ndërsa pas pranimi të lëndës së lartcekur gjykata e ka vazhduar procedurën sipas lëndës C.nr.721/15. Me datë 11.05.2017 përfaqësuesi i të paditurës ka kërkuar të ndërpritet procedura në këtë çështje kontestimore dhe të vazhdohet varësisht nga veprimet në procedurën penale, ku gjykata me datë

11.05.2017 ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan që të njoftohet lidhur me kërkesën e përfaqësuesit të palës së paditur se a është ushtruar kallëzim penal ndaj të paditurës R.B. nga ana e paditësit me aktvendimin C.nr.721/15 të datës 15.06.2017 gjykata e ka ndërprerë procedurën penale për shkak të çështjes prejudicare-paraprake. Me datë 05.07.2017 gjykata ka ndërprerë procedurën për shkak të çështjeve prejudicare-paraprake, deri kur gjykata me datë 05.07.2017 ka pranuar parashtrësën, përmes së cilës është njoftuar se kallëzimi penal është hudhur dhe procedura penale ka përfunduar, dhe pas pranimit të kësaj parashtrëse gjykata ka vazhduar me procedimin e lëndës e cilat tani ka marrë numrin C.nr.566/17 të cilën e ka përfunduar me aktgjykim me datë 14.11.2017, kundër të cilit aktgjykim palët ndërgjyqjësë, paditësi dhe e paditura kanë parashtruar ankesë, dhe Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.1993/2018 të datës 05.05.2022, e ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Pas pranimit të këtij aktvendimi, gjykata e ka caktuar seancën gjyqësore të rigjyimit në këtë çështje kontestimore për datë 22.02.2023.

Gjyqtari A.B., i ngarkuar me lëndën kontestimore C.nr.652/19, ku paditës janë I.T. dhe F.Sh., nga Prishtina dhe i paditur N.M. nga Gjilani, me deklaratën e tij me shkrim e ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës se lëndën në fjalë e ka pranuar me datë 25.06.2019, dhe pas pranimit të njëjtës ka vepruar konform dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore duke bërë fillimisht shqyrtimin paraprak të padisë, se padia a i përmban të gjitha elementet e saj siç përcaktohet me nenin 252 të LPK-së, pas kësaj me datë 22.07.2019 kam nxjerr aktvendim për përgjigje në padi të cilën së bashku me shkresat e lëndës ia kam dërguar të paditurit, i cili e ka pranuar me datë 20.08.2019 dhe i njëjti përmes postës ka dorëzuar në gjykatë përgjigje në padi dhe kjo vërtetohet përmes fletëkthesës së datës 28.08.2019, andaj deri në fazën e caktimit të seancë përgatitore me lëndën i kam ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale konform dispozitave ligjore, e për të cilat ka qenë e mundur të ndërmarr, ndërsa ka njoftuar se seancën gjyqësore për këtë çështje e ka të caktuar për datën 21.02.2023

Sa i përket mos caktimit të seancës përgatitore gjyqtari i ka potencuar në mënyrë kronologjike faktorët të cilët kanë ndikuar për këtë, duke theksuar se me datë 19.05.2015 është dekretuar si gjyqtar, dhe në atë periudhë është ngarkuar me një numër të konsiderueshëm të lëndëve dhe atë lëndë të lëmisë kontestimore kanë qenë 798 lëndë, lëndë të lëmisë jokontestimore kanë qenë 90 lëndë dhe lëndë trashëgimore 64 lëndë, dhe në kuadër të këtyre lëndëve të pranuarra kanë qenë

lëndë të periudhës 2002 e tutje, përveç këtyre lëndëve që kam qenë i ngarkuar edhe me lëndë të viteve pasuese 2016, 2017 e tutje proporcionalisht me lëndë të reja sikurse gjyqtarët tjerë. Përveç kësaj rrethane që ka ndikuar në mos caktimin e kësaj lënde, është se kam qenë i stërngarkuar me numër të madh të lëndëve, ndërlikueshmëria, ndjeshmëria ashtu edhe vjetërsia e tyre. Po ashtu nga data 19.02.2021 angazhimi im si gjyqtar mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Ferizaj- dega në Shtërpcë. Andaj sa i përket pretendimit të palës ankuese për standarde të ndryshme në të gjykuar, ju njoftoj se bazuar në të dhënat e lartcekura konsideroj se për arsye objektive ka qenë e pamundur të ndërmarr veprime tjera të parapara me ligj për caktimin e seancës përgatitore, andaj në këtë aspekt vlerësoj se nëse eventualisht do të isha i ngarkuar edhe me lëndën tjetër kontestimore ku palë paditëse është N.M., kurse të paditur I.T. dhe F.Sh., dhe po të kisha ndërmarr veprime unë si gjyqtar në atë lëndë, kurse në lëndën kontestimore me të cilën veç jam i ngarkuar ku palë paditëse është I.T. dhe F.Sh. dhe i paditur N.M., nuk do të kisha marr veprime procedurale, atëherë do të vinte në shprehje shkelja e këtij standardi nga ana ime si gjyqtar dhe inkriminimi im në shkelje disiplinore, e që në rastin konkret vlerësoj se në veprimet e mia nuk konsumojnë asnjërin nga shkeljet disiplinore që parashihen me ligj.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarëve të rasteve si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore të gjyqtarëve A.B. dhe M.F..

Autoritetit kompetent i kësaj gjykate, referuar në të dhënave nga shkresat të lëndës C.nr.652/19 me numër të SMIL-it 2019:135893 me të cilën ka qenë i ngarkuar gjyqtari A.B., dhe shkresave të lëndës 2022:099751 me të cilën është i ngarkuar gjyqtari M.F., nuk ka gjet se ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve M.F. dhe A.B., për arsyet të cilat do të elaborohen më poshtë.

Lënda kontestimore e evidentuar si: C.nr.652/19 me numër të SMIL-it 2019:135893 me të cilën është i ngarkuar gjyqtari A.B., vërtetohet se padia e paditësve I.T. nga Prishtina në cilësi të udhëheqësit të Departamentit Ligjor pranë R.B. Kosovë dhe F.Sh., nga Prishtina në cilësi të Menaxherit të Departamentit Ligjor pranë personit juridik R.B. Kosovë, kundër të paditurit N.M.,

nga Gjilani me bazë juridike shkaktimi i dëmit, fillimisht është pranuar në Gjykatën Themelore në Gjilan më 20.02.2019 dhe kjo vërtetohet përmes vulës së pranimit të kësaj gjykate.

Në shkresa të lëndës gjendet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.154/19 i datës 27.03.2019, me të cilën është detyruar i padituri N.M., nga Gjilani që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat e lëndës, ti paraqes gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar.

Me datë 10.05.2019, përmes aktit përcjellës nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, komplet shkresat e lëndës C.nr.154/2019 janë dërguar në Gjykatën e Apelit të Kosovës për vendosje lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve të kësaj gjykate. Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin CN.nr.62/19 të datës 21.05.2019 ka caktuar Gjykatën Themelore në Ferizaj si gjykatë e kompetencës lëndore dhe territoriale për të vendosur në lëndën e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.154/19. Me datë 13.06.2019 është pranuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa përmes sistemit SMIL i është ndarë në punë gjyqtarit A.B., me datë 25.06.2019.

Gjyqtari i çështjes A.B. pas pranimit të lëndës së bashku me shkresat e saj, me datë 22.07.2019 ka nxjerr aktvendimin C.nr.652/19, me të cilin ka detyruar të paditurin N.M., që në afat prej 15 ditësh, ti paraqes gjykatës përgjigje në padi. I padituri N.M., përmes përfaqësuesit të autorizuar av.G.S. i ka dorëzuar gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar, ndërsa seanca kryesore në këtë çështje kontestimore është caktuar për datë 21.02.2023.

Ndërsa sa i përket çështjes kontestimore tani e evidentuar me numër të SMIL-it 2022:099751, me të cilën është i ngarkuar gjyqtari M.F., vërtetohet se: paditësi N.M. etj nga Gjilani përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar av.E.A., kanë paraqitur padi për shpërblimin e dëmit kundër të paditurës R.B., me seli në Prishtinë dhe padia është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan me datë 16.02.2015.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan me propozimin e datës 13.10.2015, ka kërkuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës që udhëheqjen e procedurës kontestimore ndaj paditësit N.M. etj, ta caktoj një gjykatë tjetër për arsye se paditësi N.M., është gjyqtar i Gjykatës Themelore në Gjilan dhe pengesave tjera të cilat i ka cekur në propozim. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin

CN.nr.70/15 të datës 30.10.2015 ka caktuar Gjykatën Themelore në Ferizaj si gjykatë me kompetencë lëndore dhe vendore për të vendosur në këtë çështje.

Gjykata Themelore në Gjiilan përmes aktit përcjellës të datës 16.11.2015 i ka dërguar Gjykatës Themelore në Ferizaj komplet shkresat e lëndës Cn.nr.70/15 për procedurë të mëtutjeshme dhe në këtë gjykatë ka marrë numrin C.nr.721/15.

Gjyqtari i ngarkuar fillimisht me këtë çështje B.E., me datë 14.07.2016 ka kërkuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj përjashtimin nga zgjidhja e çështjes C.nr.721/15 me arsyetimin se i njëjti është në marrëdhënie kontraktore me të paditurën R.B., ndërsa me gjyqtarin N.M., është në marrëdhënie shoqërore sepse ka punuar si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjiilan së bashku me gjyqtarin N.M.

Me aktvendimin GjA.nr.482/16 të datës 14.07.2016 Kryetari i Gjykatës ka aprovuar si të bazuar kërkesën për përjashtim të gjyqtarit B.E. dhe lënda ka kaluar te gjyqtari M.F.

Gjyqtari M.F., me datë 10.10.2016 ka nxjerr aktvendim për përgjigje në padi me të cilën ka detyruar të paditurën që në afet prej 15 ditësh ti paraqes gjykatës përgjigje me shkrim në padi. E paditura R.B., me datë 03.11.2016 ka dorëzuar në gjykatë përgjigje në padi.

Gjyqtari M.F., me datë 29.03.2017 dhe 11.05.2017 ka mbajtur seanca të shqyrtimit gjyqësor. Me aktvendimin C.nr.721/15 të datës 15.06.2017 është ndërprerë procedura në këtë çështje kontestimore.

Përmes parashtrësës së datës 05.07.2017 nga pala paditëse është kërkuar vazhdimi i procedurës së ndërprere kontestimore. Me datë 14.11.2017 është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor dhe me aktgjykimin C.nr.566/17 të datës 14.11.2017 gjykata ka vendosur duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.M.

Paditësi dhe paditura brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.566/17 të datës 14.11.2017. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin AC.nr.1993/2018, të datës 05.05.2022 ka aprovuar të themelta ankesat e palës

paditëse dhe palës së paditur dhe ka prishur aktgjykimin duke e kthyer çështjen të njëjtës gjykatë për procedim të serishëm dhe gjyqtari M.F., duke vepruar sipas Aktvendimit dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, por edhe datë 22.02.2023 ka caktuar për shqyrtim çështjen kontestimore.

Gjyqtari M.F., bazuar në deklaratën e tij por edhe në të dhënat që disponon kjo Gjykatë është dekretuar si gjyqtar me datë 19.05.2015 dhe fillimisht sipas vendimit të Kryetarit të Gjykatës GJA.nr.186/15 të datës 25.05.2015 është caktuar gjyqtar në departamentin e përgjithshëm – divizioni për Kundërvajtje. Ndërsa me vendimin GjA.nr.91/16 të datës 28.01.2016 dhe i njëjti është ngarkuar vetëm me lëndë civile të vitit 2015 gjithsej 157 lëndë e si provë i ka bashkangjitur procesverbalin e pranimit të këtyre lëndëve dhe se gjatë vitit 2017 i njëjti ka kryer gjithsej 241 lëndë civile prej tyre 108 lëndë të vitit 2015, 92 lëndë të vitit 2016 dhe 41 lëndë të vitit 2017 pra të gjitha lëndët e trajtuara nga gjyqtari M.F., gjatë periudhës së vitit 2017 kur edhe ka vendosur në lidhje me padinë e paditësit N.M., e cila lëndë apo padi fillimisht është dorëzuar në gjykatë në shkurt të vitit 2015 dhe konsiderohet lëndë e vitit 2015, gjyqtari i ka trajtuar të gjitha lëndët sipas radhës dhe prioriteteve të përcaktuara sepse realisht i njëjti ishte ngarkuar me lëndë të vitit 2015 kur edhe ka kaluar si gjyqtar në divizionin civil, për të vazhduar dhe pranuar lëndë civile sipas radhës së ardhjes në gjykatë. Gjithashtu edhe pas kthimit në rivendosje të çështjes në fjalë gjyqtari M.F., ka vepruar konform prioriteteve ligjore të cilat përcaktojnë afatet ligjore për trajtimin e lëndëve të kthyera në rigjykim.

Ndërsa sa i përket gjyqtarit A.B., i cili ka në trajtim lëndën C.nr.652/19 lidhur me padinë e paditësve I.T. dhe F.Sh., ndaj të paditurit N.M. dhe pretendimeve të ankuesve se gjyqtarët kanë përdorur standarde të ndryshme në trajtimin e rasteve kur në procedurë në cilësi të paditësit janë gjyqtarët, ndërsa standard tjetër kur palë në procedurë janë paditës palët private për raste të njëjta dhe bazë juridike të njëjtë, sipas vlerësimit të autoritetit kompetent nuk është i bazuar.

Siç u cek edhe më lartë padia e paditësve I.T. dhe F.Sh., fillimisht është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan me datë 20.02.2019 dhe me datë 25.06.2019 është transferuar nga kjo gjykatë për në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe sipas sistemit për menaxhimin e lëndëve SMIL, kjo lëndë i është ndarë në punë gjyqtarit A.B. Gjyqtari A.B., sipas deklarimit të tij me shkrim, por edhe të dhënave që ka kjo gjykatë, nga fillimi kur i njëjti është dekretuar si gjyqtar ka qenë i



ngarkuar me një numër të madh të lëndëve dhe sipas procesverbaleve vërtetohet se i njëjti me të filluar punën si gjyqtar ka pranuar në punë 798 lëndë kontestimore, 90 lëndë jokontestimore dhe 64 lëndë trashëgimore, të cilat lëndë kanë qenë të viteve 2002 e tutje, për të vazhduar e pranuar lëndë të reja në mënyrë proporcionale me gjyqtarët tjerë dhe se aktualisht gjyqtari ka në trajtim lëndë që janë më të vjetra dhe për nga vitet janë të ndryshme e të cilat hynë në kategorinë e lëndëve me prioritet.

Andaj mund të qëndron pretendimi se kjo seancë nga ana e gjyqtarit A.B., nuk është mbajtur nga momenti i pranimit të saj në gjykatë nga viti 2019, dhe për këtë edhe gjyqtari i rastit është i vetëdijshëm për këtë fakt, mirëpo mos caktimi i seancës gjyqësore nga ana e gjyqtari A.B., ka ndodhur për shkak të faktorëve objektiv, duke u bazuar në ngarkesën e vazhdueshme me lëndë, ndërlikueshmërinë dhe ndjeshmërinë e rasteve që ka pasur në trajtim, si dhe fakti tjetër se gjyqtari A.B., nga data 19.02.2021 me vendim të KGJK-së, është caktuar dhe angazhuar si gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Shtërpcë, dhe një pjesë të aktivitetit të tij e ka në atë gjykatë. Po ashtu është evidente se ngarkesa me lëndë në mes gjyqtarëve nuk ka qenë proporcionale në raport me vjetërsinë lëndëve që për nga natyra konsiderohen me prioritet në mes të gjyqtarit A.B. dhe M.F., por edhe të disa gjyqtarëve të rinj që janë ngarkuar me lëndë të reja, andaj edhe KGJK-ja në planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi ka përcaktuar që të bëhet në nivelizim në mënyrë proporcionale me ngarkesë të lëndëve sa i përket lëndëve që hynë në kategorinë e kësaj strategjie dhe një rishpërndarje e tillë është planifikuar edhe në Gjykatën tonë.

Andaj për shkak të këtyre faktorëve objektiv që u theksuan më lartë nuk ka pasur trajtim apo përdorim të standardeve të ndryshme në trajtimin e lëndëve, pasi që këtu kemi pasur të bëjmë me dy gjyqtar të ndryshëm të cilët i kanë trajtuar lëndët e ndryshme. Do të mund të qëndronte pretendimi i ankuesit për aplikim të standardeve të ndryshme sikur vetëm njëri gjyqtar ti kishte pasur në trajtim të dyja lëndët dhe atë lëndën me padi ku në cilësi të palës paditëse të kishte qenë N.M. ndërsa të paditur I.T. dhe F.Sh. dhe padinë tjetër ku në cilësi të paditësit është I.T. dhe F.Sh., kurse i paditur N.M. dhe në këtë rast të kishte ndërmarre veprime vetëm në lëndën ku është paditës N.M., por meqë kemi të bëjmë me dy gjyqtar të ndryshëm të cilët kanë vendosur në lëndë të ndryshme atëherë nuk mund të themi se qëndron pretendimi se gjyqtarët kanë aplikuar standarde të ndryshme në rastin e trajtimit dhe vendosjes në rastet e tyre.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarët kanë kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**AD/GJTHFR.1/2023**

**24 shkurt 2023**

**Kryetar i Gjykatës,**

**Mustaf Tahiri**

**Iu dërgohet:**

I.T. dhe F.Sh., Parashtrues të ankesës

A.B. dhe M.F., Gjyqtarë

Këshillit Gjyqësor i Kosovës